

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, degët lokale të kësaj organizate, funksionarët dhe veprimtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ndërkaq rregullisht gjatë vitit 1998 te ne u lajmëronin familjet me paraqitjen e vrasjeve dhe zhdukjeve të anëtarëve të vet. Kur bëhet fjalë për vrasjet, rrëmbimet dhe zhdukjet e dhunshme të civilëve serb, si dhe rëniet e pjesëtarëve të UJ-së dhe MPB-së, të dhënat për këto i gjenim në raportet e mediave serbe. Hulmuesit në Prishtinë/Priština, ku e kishim zyrën që nga viti 1996, shkonin në terren. I vizitonin vendngjarjet dhe i merrnin deklaratat nga dëshmitarët, nëse kishte të tillë, dhe familjarët e personave që e kanë humbur jetën apo ishin rrëmbyer nga policia serbe apo pjesëtarët e UÇK-së. Atëbotë, nuk ishte punë e lehtë të merrej një deklaratë koncize, me të gjitha detajet e duhura për viktimat dhe ngjarjet. Shqiptarët gjendeshin nën presionin e frikës së përhershme se policia do të hynte në shtëpitë e tyre, ndërkaq pjesëtarë të familjeve të serbëve të vrarë apo të rrëmbyer ka qenë vështirë të gjendeshin, sepse, gati zakonisht, pas incidentit i braktisnin shtëpitë dhe vendbanimet. Qëllimi kryesor i hulumtimit ka qenë dokumentimi i pohimeve për krime lufte, informimi i publikut dhe ushtrimi i presionit mbi pushtetin e Republikës së Serbisë dhe UÇK-në që t'i respektojnë normat e së drejtës humanitare ndërkombëtare. Në vitin 2004, FDH ka filluar me sistemimin e bazës së të dhënave për krime lufte dhe abuzime të rënda të të drejtave të njeriut, e cila u bë funksionale në gjysmën e parë të vitit 2006. Futja e dokumentacionit të siguar, i cili përmbahej prej afro 2.500 deklaratave të mbijetuara dhe anëtarëve të familjeve të viktimave për vrasjet dhe zhdukjet e dhunshme, ka zgjatur për disa muaj. U tregua se në disa deklarata mungojnë të dhënat e rëndësishme personale për viktimat, të dhënat për varrezat masive, zhvarrimet, dhe se ka pak dokumente të mjekësisë ligjore dhe prova që janë përdorur në gjykimet pranë Gjykatës Ndërkombëtare për krime Luftë në ish Jugosllavi. Ishte kjo koha kur FDH-ja e ka hartuar planin e hulumtimit, i cili nuk e synonte vetëm regjistrimin e viktimave të krimeve të luftës, por edhe pjesëtarëve të rënë të UJ-së, MPB-së së Serbisë dhe UÇK-së. U themeluan ekipe të reja hulumtuesish dhe analistësh në Kosovë² dhe në Serbi, të cilat janë ende duke punuar së bashku në këtë projekt.

Metoda kryesore e FDH në dokumentimin e krimeve të luftës dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut përmbahet nga marrja e deklaratës nga dëshmitari, anëtar i familjes apo ndonjë person tjetër që ka njohuri indirekte për rrethanat e vrasjes, pësimin apo zhdukjes së dhunshme. Është rregull i FDH-së se aktgjykimet dhe dokumentet tjera gjyqësore, fotografitë, procesverbalet mbi obduksion, raportet mbi zhvarrime, fotografitë e përmendoreve, regjistrat e KNKK-së, regjistrat e Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur, publikimet dhe regjistrat e institucioneve të Republikës së Serbisë, KFOR-it, UNMIK-ut dhe UÇK-së përbëjnë prova të mjaftueshme se një person e ka humbur jetën apo është zhdukur në luftë dhe në lidhje me luftë. Kur bëhet fjalë për përcaktimin e rrethanave në të cilat ndonjë person ka gjetur vdekjen për shkak të shkeljes së drejtës humanitare ndërkombëtare, është rregull se këto shënime duhet të mbështeten mbi dy burime të pavarura apo mbi deklaratën e një dëshmitari dhe dokumentin zyrtar, që e konfirmojnë identitetin e viktimës. Gjatë sigurimit dhe analizimit të këtyre të dhënave, këto rregulla janë respektuar. Por ka edhe përjashtime që kanë rezultuar nga rrethanat specifike. Për shembull, në rastin e pleqve që kanë mbetur në fshat pas largimit të familjarëve dhe vendaseve, nuk ka shumë prova për rrethanat e pësimin të tyre.

2 Zyra e FDH në Kosovë u bë organizatë e pavarur në muajin prill të vitit 2011 dhe vepron me emër Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë - FHP Kosovë.